

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtare, në çështjen juridike të paditësit B. E., nga ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Y.H., avokat nga ..., kundër të paditurës NSH "T." në ..., të cilën me autorizim e përfaqëson B. P., avokat nga ..., për kompensim dëmi, vlera e kontestit 3.204,92 €, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 2692/2014 datë 10.12.2018, në seancën e kolegji të mbajtur më 8.4.2019, merr këtë

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr. 2692/2014 datë 10.12.2018.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2692/2014 datë 10.12.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës Themelore, Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 377/2010 datë 18.4.2014, me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material, dëmtimit të shkaktuar në automjetin e tij "Mercedes" Tip C220, me targa të regjistrimit 599 KS 410, i shkaktuar në aksidentin e komunikacionit më datë 15.7.2010, t'ia paguaj shumën prej 3.204,92 €, me kamatë 3.5%, të cilën bankat e paguajnë për mjetet e pa afatizuara, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1053 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ndryshuar vetëm përkitazi me kamatën, ashtu që është detyruar e paditura që paditësit për shumën e gjykuar si në dispozitivin e aktgjykimit t'ia paguaj kamatën siç ju paguajnë Bankat në Kosovë kursimtarëve të vetë në mjetet e deponuara pa destinim të veçantë mbi një vit, nga dita e marrjes së aktgjykimit në gjykatën e shkallës së parë ( 18.4.2014), e deri në pagesën definitive.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar ose ato të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK -ës, gjeti se:

Revizioni është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se më datë 15.7.2010, rreth orës 21,15 në aksin rrugor Gjilan – Kamenicë, në hyrje të fshatit ..., paditësi B. E., duke drejtuar automjetin e tij të markës "Mercedes" Tip C220, me targa të regjistrimit ..., është përplasur në pjesën e rrugës së dëmtuar, në të cilën ka qenë duke kryer punimet e paditura, me ç' rast në automjet shkactohet dëm material në vlerën prej 3204,92 €.

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se në rastin konkret paditësi ka pësuar dëm material në automjetin e vet, ashtu që sipas ekspertizës vlera e përgjithshme e dëmit është në shumën prej 3204,92 €, dhe duke pasur parasysh këtë fakt e ka detyruar të paditurën që atij t'ia paguajë shumat e cekura më afër përshkruar në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën sipas ankesës ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndërsa ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë lartësinë e dëmit material e ka vlerësuar në bazë të mendimit të ekspertit të makinerisë, i cili ka dhënë mendim profesional e të cilin mendim e ka arsyetuar edhe në shqyrtimin kryesor, ashtu që ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin, ndërsa lidhur me kamatën ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale, për të cilën arsye ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Gjykatat e instancës më të ulët në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, kur kanë gjykuar shumën për kompensim të cilën duhet ta paguajë e paditura paditësit, të cilat arsye i mbështetë edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kundërshtuar e shqyrton konform dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK, ndërsa nuk gjeti shkelje të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimin se aktgjykimi i kundërshtuar dhe ai i gjykatës së shkallës së parë janë marrë në bazë të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 1 lidhur me nenin 319 par.1 e 2 të LPK –ës, sepse gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë raportin e policisë i cili nuk është administruar si provë, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase me vështrim në procesverbalin e shqyrtimit kryesor datë 18.4.2014, gjykata vërtetoi faktin se është lexuar raporti i policisë i datës 15.7.2010, të cilin pala e paditur e ka kundërshtuar, ndërsa neni 319 i LPK –ës ka të bëjë me detyrimin e palëve në procedurë që të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet e veta. Lidhur me pretendimin se nuk është vërtetuar baza e përgjegjësisë kundërvajtëse e të paditurit, kjo Gjykatë konstaton se me të drejt gjykatat e instancës më të ulët kanë vlerësuar se në bazë të ekspertizës së komunikacionit është vërtetuar fakti se deri të aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimeve të Kompanisë Tali – këtu e paditura, e cila ka kryer punimet në rrugë – mirëmbajtjen e rrugës dhe ka qen e obliguar që gjatë punimeve në rrugë të ndërmarr masa të sigurisë, ashtu që të vendosë sinjalizim horizontal, vertikal dhe ndriçues, andaj pretendimet e cekura në revizionin e të paditurës në këtë drejtim u vlerësuan si të pabazuara.

Pretendimin se aktgjykimi i kundërshtuar është marrë në bazë të shkeljeve thelbësore nga neni 182 par.2 pika (n) të LPK –ës, sepse dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, nuk ka arsye për faktet vendimtare, se ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtjen e dokumentit ose të procesverbalit, nga Gjykata Supreme e Kosovës u

vlerësua si i pabazuar, sepse në revizion nuk është cekur asnjë pretendim konkret se në cilën pjesë të aktgjykimit dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin, ndërsa nga kjo Gjykatë u vlerësua se dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe në harmoni me arsyetimin dhe provat e prezantuara në shkresat e lëndës, kurse në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme për një gjykim të drejtë e të bazuar në ligj.

Pretendimin e cekur në revizion se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të gabuar kanë zbatuar të drejtën materiale, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase në revizion nuk ceket se cila dispozitë është zbatuar në mënyrë të gabuar dhe me asnjë pretendim konkret nuk është vënë në pikëpyetje ligjshmëria e aktgjykimit të kundërshtuar, ndërsa sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 185 të LMD –ës kur kanë obliguar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shumën e cekur në dispozitiv.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimet e revizionit se nuk është vërtetuar përgjegjësia e të paditurës; se nuk i janë dërguar gjykatës fotografit në kolor nga vendi i ngjarjes; se nuk janë siguruar shkresat e lëndës nga Divizioni i Kundërvajtjes lidhur me të pandehurin S. Z.; se nuk është elaboruar raporti i policisë si provë; nuk është bërë skicimi i vendit të ngjarjes; nuk është bërë matja dhe fotografimi i gropës; nuk janë matur gjurmët e frenimit, por të gjitha këto kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, për të cilat në bazë të nenit 214 par.2 të LPK –ës revizioni nuk mund të paraqitet.

Nga sa u tha më lart, e në pajtim me nenin 222 të LPK -ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**

Më 8.4.2019, Rev.nr.95/2019

Kryetarja e kolegjit,  
Emine Kaçiku